Në këtë kapitull përfshihen : ( Nënshtrësë zhavori; Shtresë beton i varfër C12/15; Ngjeshje tabani për sheshin në L0; Shtresë stabilizanti t=15cm; Shtresë betoni C25/30 me kuarc, përfshirë zgarë metalike  $\Phi 6$ mm etj )

- **Punime Konstruksioni**

Në këtë kapitull përfshihen : ( F.V. Kollona druri (44x44)cm, BSH GL24h; F.V. Trarë laminarë prej druri pishe 2x(22x48)cm GL24h; F.V. Trarë laminarë prej druri pishe (40x48)cm GL28h; F.V. Trarë laminare prej druri pishe (24x36)cm GL28h; Konstruksion çeliku i zinkuar dhe i lyer me bojë ngjyre të zezë, për bashkimin e elementeve strukturor prej druri me njeri-tjetrin; Konstruksion çeliku të zinkuar për bazat e kollonave, S235 J2; F.V. Prikoniera prej çeliku të zinkuar Hilti HIT-Z M20x350, përfshirë ankorimin kimik me Hilti HIT-HY 200A (Lank = 22cm); Mbushje me material "grout" ndërmjet themelit b/a dhe bazamentit prej çeliku të kollonave (t=5cm); Tavan (solete) prej druri të



fortë laminare të kryqëzuar, 100 mm, NSI, me strukturë me 5 shtresa të ngjitura me ngjitës poliuretani; F.V. Tirante çeliku M22, S540N, të zinkuar dhe të lyer me boje ngjyrë të zezë (sistemi "Besista" ose ekuivalent) etj.)

- **Punime për Sallat e Mbledhjeve**

Në këtë kapitull përfshihen : ( Konstruksion çatie dyshe, me dru pishe laminare pa lysterje, përfshirë aksesorët e montimit; Çati me vetratë xhami të laminuar dhe të temperuar 6/0.76/6mm, me shina mbuluese alumini; F.V. Dyer rrotulluese me xham të laminuar dhe të temperuar 6/0.76/6mm, në zonën e sallës së mbledhjes h=4.00m; F.V. Dyer rrotulluese me xham të laminuar dhe të temperuar 6/0.76/6mm, me lartësi h=4.30m; F.V. Vetratë me xham të laminuar dhe të temperuar 6/0.76/6mm, me lartësi h=5.60m etj. )

- **Punime për Shkallët / Parapete / Dysheme**

Në këtë kapitull përfshihen : ( F.V. Profile tubolare çeliku 300x200x16mm per shkallët, te zinkuara dhe te lyster me boje, ngjyre gri i erret, S235 J0; Ulese prej druri ne shkallen L0/L1; Parapete çeliku me lartesi h=106cm, te zinkuar dhe te lyster me pluhur, ngjyre gri i erret; Konstruksion çeliku per mbylljen anesore te dyshemeve dhe si strukture mbajtese e parapeteve, i zinkuar dhe i lyster me pluhur, ngjyre gri i erret; F.V. Dysheme per pjerresi, me binare dhe ristela bredhi 0-120mm dhe panele OSB 25mm; Membranë hidroizoluese me emulsion bitumi dhe 2 shtresa fletë bitumi; Shtrese granil lumi 5-10mm nen pllaka betoni, t=6cm; Shtrese me pllaka betoni 60x60cm per dysheme, t=4cm, me te njejten finiteure si shkallët, i shtruar mbi granil; Rimeso per siperfaqet fundore rrethuese te tavaneve (soletave), ekzekutuar ne dru pishe me dimensione deri ne 32/120 mm etj. )

- **Punime fasade dhe terrace**

Në këtë kapitull përfshihen : ( Skela metalike me tubo per fasaden e objektit (qira per 4 muaj); Konstruksion me dru pishe laminare 50x400x4360mm, perfshire aksesorët e fiksimit etj. )

- **Punime për vazot / enët për mbajtjen dhe mbjelljen e luleve**

Në këtë kapitull përfshihen : ( Vazo/Ene prej çeliku "Corten" 3mm per pergatitjen dhe levizjen e luleve, me dimensione 211/105/100; Vazo/Ene prej çeliku te zinkuar dhe te lyster, per lule me dimesione sipas projektit, midis trareve laminare (40x48)cm GL28h; Vazo e brendshme prej çeliku me spesor 25mm, te lyster me boje, perfshire aksesorët per montim; Veshje gjysem- sferike per vazot/enët e luleve, prej çeliku me spesor 3mm, te lyster me boje, perfshire aksesorët per montim; Membrane hidroizoluese me rezine tipi StoPox ose analog; Varese çeliku te zinkuara dhe te lyster per bimët kacavjerrese "Liana" etj. )

- **Punime elektrike**

Në këtë kapitull përfshihen : ( Instalimet Elektrike : Sistemi i kanalinave; Impianti i instalimeve te fuqise dhe ndricimit; Instalimet e sistemit te sinjalizimit te zjarrit; Instalimet e sistemit te lajmerimit publik zanor; Instalimet e sistemit te vezhgimit CCTV; Rrjeti i transmetimit te te dhenave; \_ Pajisjet Elektrike : Sistemi elektrik i ndricimit; Sistemi i sinjalizimit te zjarrit; Sistemi I lajmerimit zanor; Sistemi i monitorimit CCTV; Sistemi I furnizimit te rezervuar UPS; Kontrolli I vaditjes(Sistem automatizimi dhe kontrolli); Kontroll KNX per ndricimin(perfshire kabllimet); Sistemi I furnizimit gjenerator (opsional) etj.)

- **Punime mekanike**

Në këtë kapitull përfshihen : ( Punimet mekanike : Sistemi i kondicionimit; Sistemi hidroteknik; Sistemi MKZ ; \_ Pajisjet mekanike : Sistemi i kondicionimit; Sistemi hidroteknik; Sistemi MKZ etj. )

### **Bimësia dhe peisazhi**

Në këtë kapitull përfshihet : ( Furnizimi dhe punime për mbjelljen dhe vendosjen e bimëve në vende te posaçme etj. )

Shtojca 8

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE**

**Grafiku ne fazen e dyte.**

**Afatet e realizimit të punimeve: 6 muaj**

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

## Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës A Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*).

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga

vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

***Pika 2.3.1/a,** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

## PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P - 1. A Punime gjermimi në tokë.  
 N.P - 2. B Ndertime civile dhe industrial.  
 N.P - 11.A Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise.  
 N.P - 12.B Punime te inxhinerise se mjedisit.

## PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S - 4. B Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese.  
 N.S - 8. E Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.  
 N.S - 12.B Impiane teknologjik, termike, dhe te kondicionimit.  
 N.S - 18.A Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur po ashtu me licencë në zbatim sipas kategorisë të mëposhtme:
  - N/Z/A/6 Zbatim ne konservim dhe restaurim i arkitektures se projektuar
  - N/Z/A/7 Zbatim ne konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rruge, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (nje) Arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) inxhinier (Dega e Përpunimit të Drurit)
- 1 (nje) inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) inxhinier Mjedis
- 1 (nje) inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e **personelit kryesor** në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e **personelit kryesor** në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 290 persona** për periudhën, (Maj 2022 – Korrik 2022), e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (Maj 2022 – Korrik 2022),

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi/qira/kontrate furnizimi:

1.	Eskavator me goma	– 2 cope
2.	Minieskavator	– 2 cope
3.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 24 ton	– 3 copë
4.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10 - 18 ton	– 1 copë
5.	Kamionçinë (deri në 6 ton)	– 2 copë
6.	Impiant automatik betoni	– 1 copë
7.	Rrul gome – hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton)	– 1 copë
8.	Kompresor	– 2 copë
9.	Autobetoniere	– 2 copë

10.	Mjet autovinç	– 2 copë
11.	Autovinç me krahe jo me pak se 45 m	– 1 copë
12.	Fadrome Kove perpara dhe mbrapa	– 1 copë
13.	Pompe betoni	– 1 cope
14.	Vinc kulle me krah jo me pak 45 m	– 1 copë

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

### 2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente*



---

*mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*

Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe. Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

*Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se AK të japë kontratën.*

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

**Shtojca 10***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
 \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigjja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik  
 (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:

<p>vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>	<p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]          Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]          Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:          Adresën e ueb-it: [shkruajeni]          Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]          Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:          Adresën e ueb-it: [shkruajeni]          Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]          Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:          Adresën e ueb-it: [shkruajeni]          Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p>

	Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

---

përbjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	
--	--

**B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

--

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;	Po [ ]
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohej dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po [ ]
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po [ ]
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po [ ]
5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:  a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;  b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po [ ]
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [ ] Jo [ ]
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në	Po [ ] Jo [ ]

dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).	
8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :  a) çmimet;  b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;  c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose  d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.	Po [ ] Jo [ ]
9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose kërkesat specifike të punëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	Po [ ] Jo [ ]
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	Po [ ] Jo [ ]

**B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:  Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me	<b>Punonjës</b>  Po [ ] Jo [ ]



<p>dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p> <p><b>Shënim:</b> nëse ofertuesi do të mbështetet edhe në fuqinë punëtore të subjekte të tjera, duhet të deklarojë:</p> <p>Operatori ekonomik _____, do të mbështetet në kapacitetet njerëzore (fuqinë punëtore), të subjektit mbështetës _____, i cili do të vërë në dispozicion _____ punonjës, (me profesionet përkatëse: _____, _____, _____ (nëse është rasti).</p>	<p>Nëse, po, numri i punonjësve</p> <p>Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:</p> <p>1. Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>2. Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>3. Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p><b>Makineri e mjete</b></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>
---	--

**C: DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zoteroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën.

Mjetet e poshtëshënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do anagazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				

3				
4				
5				

<b>Me qira</b>					
<b>Lloji i Mjetit</b>	<b>Targa e mjetit</b>	<b>Nr. Lejes qarkullimit të mjetit</b>	<b>Nr. Shasisë së mjetit</b>	<b>Nr. Kont së qerasë (noterisë)</b>	<b>Afati i kontratës qerasë (data e fillimit dhe mbarimit)</b>
1					
2					
3					
4					
5					
6					

<b>Kontratë furnizimi</b>				
<b>Materiali/prod ukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit</b>	<b>Nr. Kont së furnizimit (noterisë)</b>	<b>Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)</b>	<b>Të tjera</b>	
1.				
2				

3				
4				

#### D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj <sup>1</sup> nën përgjegjësinë time të vetme se:	
Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.	
Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:  Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, etj .,  i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.	

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Firma** \_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

<sup>1</sup> Kjo deklaratë ka si qëllim garantimin e disponueshmërisë së mjeteve për plotësimin me sukses të kontratës objekt prokurimi sipas kërkesave të makinerive në DST

- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të Informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

***Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

**Shtojca 11**

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

**FORMULAR VLERËSIMI****(Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)**

Autoriteti ose Enti kontraktor/Investitori	
Adresa/ Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
<b>VËRTETOJ SE:</b>	
Autoriteti ose enti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/  Bashkimit të operatorëve NIPTET/  Nënkontraktoret NIPTET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar	
Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur
	E papërmbushur
<b>Firma</b>	
<b>Vula e Autoritetit/Entit Kontraktor</b>	

**Shtojca 12**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti /enti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

**Projekti dhe preventivat do te dergohet ne fazen e dyte mbas fazes se parakualifikimit sebashku me ftesen per oferte.**

**Shtojca 13****Formulari i Njoftimit të Skualifikimit<sup>2</sup>**

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit të njoftimit të fituesit sipas parashikimeve të Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**

---

<sup>2</sup>Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore

**Shtojca 14**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit:

Numri i procedurës /referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*

Vlera \_\_\_\_\_  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:



---

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej \_\_\_\_\_ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**[Titullari i Autoritetit/entit Kontraktor]**

**Shtojca 15**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 3**

*(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)*

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit

Numri i procedurës / referenca e Lotit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, Sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
     *Emri i plotë i shoqërisë*      *Numri i NIPT-t*      *Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
     *Emri i plotë i shoqërisë*      *Numri i NIPT-it*      *Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
